

LIGJ
Nr. 1/2025

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES
SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE
PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT
“HEKURUDHAT SHQIPTARE – REHABILITIMI I LINJËS HEKURUDHORE
TIRANË–DURRËS DHE NDËRTIMI I LINJËS HEKURUDHORE PËR NË
AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS”, RATIFIKUAR ME LIGJIN NR.
29/2017**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “ç”, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit “Hekurudhat shqiptare – Rehabilitimi i linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe ndërtimi i linjës hekurudhore për në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës”, ratifikuar me ligjin nr. 29/2017, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 30.1.2025.

Shpallur me dekretin nr. 28, datë 12.2.2025, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

MARRËVESHJE NDRYSHUESE

NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E HUAS TË DATËS 29 DHJETOR 2016 NDËRMJET
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE
ZHVILLIM

Datë 3 tetor 2024

Kjo marrëveshje ndryshuese ("Marrëveshja Ndryshuese") është bërë më __ tetor 2024 ndërmjet palëve të mëposhtme:

1. **Republikës së Shqipërisë**, të përfaqësuar nga Ministria e Financave ("**Huamarrësi**"); dhe
2. **Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim**, një organizatë ndërkombëtare e krijuar me traktat ("**BERZH-i**");

Duke pasur parasysh se:

A. Huamarrësi ka lidhur një marrëveshje huaje, datë 29 dhjetor 2016, me BERZH-in ("**Marrëveshja Origjinale**"), në bazë të së cilës Banka ka rënë dakord t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 36,870,000 euro, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në atë marrëveshje dhe në Marrëveshjen e Projektit më datë fillestare datën 17 maj 2017, ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Bankës, të ndryshuar herë pas here ("**Marrëveshja e Projektit**");

B. Huamarrësi dhe BERZH-i dëshirojnë të ndryshojnë Marrëveshjen Origjinale dhe Marrëveshjen e Projektit në disa aspekte, mbi dhe sipas dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese dhe Marrëveshjes së Projektit (të ndryshuar në ose rreth datës së saj).

Tashmë, si rrjedhojë, duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët e kësaj Marrëveshjeje bien dakord si më poshtë:

Seksioni 1. Përkufizimet dhe interpretimi

a) Në këtë Marrëveshje Ndryshuese:

"**Datë e hyrjes në fuqi**" ka kuptimin e dhënë në seksionin 3 të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

"**Marrëveshje Origjinale**" ka kuptimin e dhënë në pikën A.

b) Termat e përcaktuar në Marrëveshjen Origjinale (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose duke iu referuar ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti tjetër) kanë, përveç kur përcaktohet ndryshe këtu, të njëjtin kuptim në këtë Marrëveshje Ndryshuese. Dispozitat e seksionit 1.02 të Marrëveshjes Origjinale kanë efekt sikur të ishin përcaktuar plotësisht në këtë Marrëveshje Ndryshuese, *mutatis mutandis*.

c) Marrëveshja Origjinale dhe kjo Marrëveshje Ndryshuese do të lexohen dhe interpretohen si një dokument i vetëm.

Seksioni 2. Ndryshimi dhe vazhdimësia

a) Çdo Palë jep pëlqimin për ndryshimin e Marrëveshjes Origjinale të parashikuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese.

b) Me efekt në dhe që nga data e hyrjes në fuqi, Marrëveshja Origjinale do të ndryshohet siç specifikohet në skedulën i të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

c) Dispozitat e Marrëveshjes Origjinale do të vazhdojnë në fuqi dhe efekt të plotë, me përjashtim të ndryshimeve nga kjo Marrëveshje Ndryshuese.

Seksioni 3. Data e hyrjes në fuqi

Data e hyrjes në fuqi do të jetë data në të cilën BERZH-i ka njoftuar Huamarrësin me shkrim pas marrjes të sa vijon:

1. Një opinion i ligjor të Huamarrësit nga ministri i Drejtësisë, me anë të së cilës konfirmohet, se: i. kjo Marrëveshje Ndryshuese dhe Marrëveshja Origjinale e ndryshuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese është autorizuar ose ratifikuar sipas rregullave nga, dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Huamarrësit; dhe ii. secila prej Marrëveshjes Ndryshuese dhe Marrëveshjes Origjinale të ndryshuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese përbën për Huamarrësin një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish të detyrueshëm, të zbatueshëm në përputhje me kushtet e tyre përkatëse; dhe

2. BERZH-it i është dhënë një opinion ligjor nga drejtuesi i departamentit juridik të Subjektit të Projektit në emër të Subjektit të Projektit; se i. Marrëveshja e Huas Subsidiare (plotësuese) (e ndryshuar) është autorizuar dhe ekzekutuar sipas rregullave dhe dorëzuar në emër të Subjektit të Projektit dhe përbën

një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish të detyrueshëm për Subjektin e Projektit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij; dhe ii. Marrëveshja e Projektit (e ndryshuar) është autorizuar sipas rregullave dhe ekzekutuar dhe dorëzuar në emër të Subjektit të Projektit dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjërish të detyrueshëm për Subjektin e Projektit, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij.

Seksioni 4. Përfaqësimet dhe garancitë

a) Huamarrësi përfaqëson dhe garanton BERZH-in, si më poshtë:

1. Huamarrësi ka të gjithë kompetencën dhe autoritetin e nevojshëm për të ekzekutuar, dorëzuar dhe përmbushur të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

2. Huamarrësi ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar ekzekutimin, dorëzimin dhe përmbushjen prej tij të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

3. Kjo Marrëveshje Ndryshuese është ekzekutuar dhe dorëzuar sipas rregullave nga Huamarrësi dhe kjo Marrëveshje Ndryshuese përbën detyrimet e tij të vlefshme dhe ligjërish të detyrueshme, të zbatueshme ndaj tij, në përputhje me kushtet e Marrëveshjes.

4. Të gjitha pëlqimet, autorizimet dhe veprimet e çdo lloji të nevojshme, për ekzekutimin e vlefshëm, dorëzimin dhe përmbushjen nga ana e tij të kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, janë marrë dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

b) Huamarrësi pranon se ka bërë përfaqësimet dhe garancitë e mësipërme, me qëllim për të nxitur BERZH-in të lidhë këtë Marrëveshje Ndryshuese dhe se BERZH-i ka lidhur këtë Marrëveshje Ndryshuese në bazë të dhe duke u mbështetur plotësisht në secilën prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive. Huamarrësi garanton se nuk ka dijeni për ndonjë fakt ose çështje shtesë, mosveprimi i të cilave e bën ndonjë prej këtyre përfaqësimeve dhe garancive çorientuese ose që do të pritej ose mund të pritej në mënyrë të arsyeshme të ndikonte në gjykimin e një investitori të mundshëm në lidhjen e kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese.

Seksioni 5. Garanci të mëtejshme

Huamarrësi, me kërkesë të BERZH-it dhe me shpenzimet e tij, do të kryejë të gjitha veprimet dhe çështjet e nevojshme ose të dëshirueshme për t'u dhënë efekt ndryshimeve të bëra ose që do të bëhen, në përputhje me këtë Marrëveshje Ndryshuese.

Seksioni 6. Të ndryshme

a) Të gjitha referencat për “Marrëveshjen” në Marrëveshjen Origjinale dhe të gjitha referencat për Marrëveshjen Origjinale në të gjitha instrumentet dhe marrëveshjet e ekzekutuara sipas saj, do t'i referohen Marrëveshjes Origjinale të ndryshuar nga kjo Marrëveshje Ndryshuese.

b) Kjo Marrëveshje Ndryshuese mund të ndryshohet vetëm me një instrument me shkrim të nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i Përfituesit dhe nga një zyrtar i autorizuar i BERZH-it.

c) Kjo Marrëveshje Ndryshuese mund të ekzekutohet në disa kopje, secila prej të cilave do të konsiderohet origjinale, por të gjitha së bashku do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

d) Dispozitat e Seksioneve 8.01, 8.03, 8.04, 10.01, 10.02, 10.03 dhe 10.04 të Termave dhe Kushteve Standarde janë përfshirë në këtë Marrëveshje me referencë dhe janë bërë pjesë e kësaj Marrëveshjeje Ndryshuese, sikur të ishin përcaktuar plotësisht këtu *mutatis mutandis* dhe (pa cenuar përgjithësinë e saj), sikur referenca në këtë “Marrëveshje” të ishte për këtë Marrëveshje Ndryshuese.

e) Asgjë në këtë Marrëveshje Ndryshuese nuk do të interpretohet si heqje dorë nga BERZH-i nga ndonjë prej privilegjeve, imuniteteve dhe përjashtimeve të dhëna BERZH-it, sipas Marrëveshjes Themeluese të BERZH-it, konventës ndërkombëtare ose ndonjë ligji të zbatueshëm.

Në dëshmi të kësaj, Palët e kësaj Marrëveshjeje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë siguruar që kjo Marrëveshje Ndryshuese të ekzekutohet në tri kopje dhe të dorëzohet si akt zyrtar në datën e shkruar më sipër.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: /Nënshkrimi/

Emri: Z. Petrit Malaj

Titulli: Ministër i Financave

BANKA EVROPIANE

PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: /Nënshkrimi/

SKEDULI 1

NDRYSHIMET NË MARRËVESHJEN ORIGJINALE TË HUAS

Marrëveshja Origjinale ndryshohet si më poshtë:

A. Pika e pestë e preambulës së Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me tekstin e mëposhtëm:

“**Duke pasur parasysh se** Banka ka siguruar fondet e bashkëpunimit teknik mbi bazën e një granti, për të ndihmuar në zbatimin e një pjese të Projektit;”.

B. Pikat shtatë dhe tetë të Preambulës së Marrëveshjes Origjinale fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me sa vijon:

Duke pasur parasysh se KIBP-ja ka dhënë një grant deri në shumën 35,435,000 euro për të bashkëfinancuar koston e kapitalit të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve, dhe mbështetjen e zbatimit të Projektit, në përputhje me metodologjinë e tyre të re për mbështetjen e investimeve në infrastrukturë në Ballkanin Perëndimor; dhe

Duke pasur parasysh se Banka ka rënë dakord, në bazë të, *ndër të tjera*, sa më sipër, t'i japë Huamarrësit një hua në shumën 77,570,000 euro, sipas termave dhe kushteve të specifikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje dhe në Marrëveshjen e Projektit me datë fillestare 17 maj 2017, ndërmjet Subjektit të Projektit dhe Bankës, të ndryshuar herë pas here (“Marrëveshja e Projektit”, siç përcaktohet në Termat dhe kushtet standardë”).

C. Seksionet 1.01 (c) dhe (d) të Marrëveshjes Origjinale fshihen në tërësi dhe zëvendësohen me sa vijon:

“c) Përkufizimi “Praktikë e Ndaluar” në seksionin 2.02 të Termave dhe kushteve Standarde ndryshohet, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, dhe lexohet si më poshtë:

“Praktikë e Ndaluar” ka kuptimin siç përcaktohet në Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, në fuqi në kohën kur është lidhur Marrëveshja e Huas.”.

“d) Përkufizimi “Faqja e referencës” në seksionin 2.02 të Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, dhe lexohet si më poshtë:

“Faqja e referencës” për Huat e shprehura në euro është shfaqja e normave të ofruara ndërbankare të Eurozonës për depozitat në euro, të emërtuar si faqja EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters (ose faqe të tjera që mund të zëvendësojnë EURIBOR01 në shërbimet Thomson Reuters, me qëllim paraqitjen e normave të ofruara ndërbankare të Eurozonës për depozitat në euro).”.

D. Seksioni 1.01 (f) i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“f) Seksioni 3.04(a) i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si më poshtë:

“a) Nëse Huaja i nënshtrohet një Norme Interesi të Ndryshueshme, atëherë, për qëllimet e seksionit 3.04(b) më poshtë, Norma Përkatese e Interesit të Tregut do të jetë:

i. për periudhën e parë të Interesit të çdo Tërheqjeje, norma e ofruar në vit për depozitat në euro, e cila shfaqet në Faqen e Referencës që nga ora 11:00 paradite, me orën e Brukselit, në datën përkatëse të përcaktimit të interesit për periudhën që është e barabartë me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi (ose nëse një normë e tillë nuk shfaqet në faqen e referencës për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e kësaj Periudhe Interesi, por normat (“Normat e Referencës”) shfaqen në Faqen e Referencës për një periudhë më të shkurtër dhe për një periudhë që është më e gjatë sesa kohëzgjatja e kësaj Periudhe Interesi, Norma Përkatese e Interesit të Tregut do të jetë norma (e rrumbullakosur për lart, nëse është e nevojshme, me katër shifra dhjetore) që do të ishte e zbatueshme për një periudhë të barabartë me kohëzgjatjen e kësaj periudhe interesi, siç përcaktohet nëpërmjet përdorimit të interpolimit linear duke iu referuar normës së referencës që shfaqet në faqen e referencës për periudhën që është periudha tjetër më e shkurtër në kohëzgjatje sesa kohëzgjatja e kësaj Periudhe Interesi dhe normës së referencës që shfaqet në faqen e referencës për periudhën që është periudha tjetër më e gjatë sesa kohëzgjatja e kësaj Periudhe Interesi); dhe

ii. për çdo Periudhë të mëpasshme Interesi, norma e ofruar në vit për depozitat në euro që shfaqet në faqen e referencës që nga ora 11:00 paradite, me orën e Brukselit, në Datën përkatëse të Përcaktimit të Interesit për periudhën që është më afër kohëzgjatjes së kësaj Periudhe Interesi (ose, nëse dy periudha janë njësoj pranë kohëzgjatjes së kësaj Periudhe Interesi, mesatarja e dy normave përkatëse);

me kusht që:

1. Nëse, për çfarëdo arsye, Norma Përkatëse e Interesit të Tregut nuk mund të përcaktohet në atë kohë, duke iu referuar Faqes së Referencës, Norma Përkatëse e Interesit të Tregut do të jetë norma në vit që Banka vendos të jetë mesatarja aritmetike (e rrumbullakosur për lart, nëse është e nevojshme, deri në katër shifra dhjetore) të normave të ofruara në vit për depozitat në euro në një shumë të krahasueshme me pjesën e Huas, sipas një norme interesi të ndryshueshme të planifikuar që të jetë e konsiderueshme gjatë periudhës përkatëse të interesit për një periudhë të barabartë me Periudhë të tillë Interesi që kuotohen për bankat kryesore në tregun ndërbankar të Eurozonës, siç i njoftohet Bankës nga të paktën dy banka kryesore aktive në tregun ndërbankar të Eurozonës (për euro) të zgjedhura nga Banka; dhe

2. Nëse në përputhje me kushtet e specifikuara në këtë seksion 3.04(a), Norma Përkatëse e Interesit të Tregut do të ishte nën zero, Norma Përkatëse e Interesit të Tregut do të konsiderohet të jetë zero.”.

E. Seksioni 1.01 (h) i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“h) Seksioni 3.09(a)(iii) i Termave dhe Kushteve Standarde, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, ndryshohet dhe lexohet si poshtë: “iii. Norma Përkatëse e Interesit të Tregut ose, nëse ka ndodhur një rast i mosfunksionimit së tregut, norma e cila shpreh si normë përqindjeje në vit koston për Bankën për financimin e Huas nga cilido burim që Banka mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme (ose sipas opsionit të Bankës, Norma Përkatëse e Interesit të Tregut, nëse është e disponueshme), me kusht që nëse norma në bazë të këtij nënparagrafi (iii) do të ishte nën zero, norma do të konsiderohet të jetë zero.”.

F. Seksioni 1.01 (j) i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

j) Seksioni 3.13(a)(1)(B) i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, dhe lexohet si më poshtë: “B. Norma e cila shpreh si normë përqindjeje në vit koston për Bankën të financimit të Huas nga cilido burim që Banka mund të zgjedhë në mënyrë të arsyeshme (ose, sipas opsionit të Bankës, Norma Përkatëse e Interesit të Tregut, nëse është e disponueshme), siç Banka i njofton Huamarrësit sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast përpara se interesi të bëhet i kërkueshëm për t’u paguar në lidhje me Periudhën përkatëse të Interesit; me kusht që nëse norma në bazë të këtij nënparagrafi B do të ishte nën zero, norma do të konsiderohet të jetë zero;”.

G. Me shtimin e seksioneve të reja 1.01 (k), (l), (m), (n) dhe (o), si më poshtë:

k) Seksioni 4.03 i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si më poshtë:

“Seksioni 4.03. Prokurimi

a) Përveç kur Banka bie dakord ndryshe, prokurimi i mallrave, punëve dhe shërbimeve, duke përfshirë shërbimet e konsulentëve, të kërkuara për Projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e Huas, do të rregullohet nga Rregullat e Prokurimit të BERZH-it dhe dispozitat e specifikuara në Marrëveshjen e Huas.

b) Nëse Banka vendos, në përputhje me Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, që ndonjë nga Huamarrësi, Garantuesi, ndonjë Subjekt i Projektit, furnitorët, nënfurnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët ose nënkonsulentët për hyrjen në konkurrencë ose për ekzekutimin e ndonjë marrëveshjeje, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t’u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas), është përfshirë në ndonjë Praktikë të Ndalar, Banka mund ta deklarojë një marrëveshje të tillë si të papërshtatshme për financim, dhe Banka mund të ndërmarrë cilindo nga Veprimet Përmbartimore dhe Veprimet Rregulluese të përcaktuara në Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore.

c) Secili nga Huamarrësi, Garantuesi dhe Subjekti i Projektit do të sigurojë, në lidhje me ato pjesë të Projektit për të cilat një subjekt i tillë është drejtpërdrejt përgjegjës, siç specifikohet në Marrëveshjen e Huas, që në dokumentet e tenderit dhe në çdo kontratë në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t’u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas), përfshihen dispozitat:

i. deklarin se furnitorët, nënfurnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët nuk duhet dhe nuk do të autorizojnë ose lejojnë asnjë nga zyrtarët, drejtorët,

punonjësit e autorizuar, filialet, agjentët ose përfaqësuesit e tyre që të përfshihen në ndonjë Praktikë të Ndaluar, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas); dhe

ii. njoftimin për furnitorët, nënfurnitorët, kontraktorët, nënkontraktorët, koncesionarët, konsulentët dhe nënkonsulentët se Banka ka të drejtë të kërkojë Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, duke përfshirë çdo veprim përmbartimor dhe veprim rregullues të përcaktuar në to, në lidhje me pretendimet për praktikën e ndaluar në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas).”.

l) Seksioni 4.04(a)(ii) i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, dhe lexohet si më poshtë:

“ii. t’i japë Bankës menjëherë informacionin që Banka mund t’i kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme dhe t’u mundësojë përfaqësuesve të Bankës, me kërkesë të Bankës:

A. Të vizitojnë çdo objekt dhe kantier ndërtimi në lidhje me Projektin ose ndonjë nga ambientet e tjera ku kryhet biznesi i Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit;

B. Të kenë akses dhe të kontrollojnë çdo dhe të gjitha mallrat, punët dhe shërbimet e financuara nga të ardhurat e Huas dhe çdo impiant, instalim, vendndodhje, punim, ndërtesë, pronë, pajisje, asete, libra, llogari, regjistrime dhe dokumente të Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit, dhe të lejojnë që këto dokumente dhe llogari të auditohen nga audituesit e Bankës; dhe

C. Të takohen dhe të zhvillojnë diskutime me këta përfaqësues dhe punonjës të Huamarrësit, Garantuesit ose Subjektit të Projektit, siç Banka mund ta çmojë të nevojshme dhe të përshtatshme,

në secilin rast, duke përfshirë në mënyrë, që: 1. Të lehtësojnë monitorimin dhe vlerësimin e Projektit nga Banka dhe t’i mundësojnë Bankës që të shqyrtojë dhe trajtojë çdo kërkesë drejtuar IPAM-it lidhur me Projektin; dhe 2. Të vlerësojnë nëse ka ndodhur një Praktikë e Ndaluar në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas);”.

m) Seksioni 7.01 (a) (xvi) i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si më poshtë: “xvi. në përputhje me Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, Banka ka vendosur që Huamarrësi (përveç anëtarit), Subjekti i Projektit ose një Filial i këtyre subjekteve është përfshirë në listën e Bankës të personave ose subjekteve që janë të papërshtatshëm për të marrë një kontratë të financuar nga Banka ose për financim nga Banka, siç kjo listë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës; ose”.

n) Seksioni 7.02(d) i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe lexohet si më poshtë: “d) Nëse, në përputhje me Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, Banka vendos që Huamarrësi (përveç anëtarit), subjekti i Projektit ose një filial i këtyre subjekteve është përfshirë në listën e Bankës të personave ose subjekteve që janë të papërshtatshëm për të marrë një kontratë të financuar nga Banka ose për financim nga Banka, siç kjo listë mund të gjendet në faqen e internetit të Bankës, Banka mund të anulojë, duke i dhënë njoftim Huamarrësit dhe Garantuesit, të gjithë ose një pjesë të Huas, kur jepet njoftimi.”.

o) Seksioni 8.01 i Termave dhe Kushteve Standarde ndryshohet, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, për të përfshirë një Seksion të ri 8.01(b), me tekstin e mëposhtëm:

“b) Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e këtyre Termave dhe Kushteve Standarde, Marrëveshjes së Huas, Marrëveshjes së Garancisë ose çdo Marrëveshjeje Projekti, Huamarrësi, Garantuesi dhe çdo Subjekt i Projektit çmohen se pranojnë që Banka ka të drejtë të kërkojë Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore, duke përfshirë çdo veprim Përmbartimor dhe Veprim Rregullues të përcaktuar aty, për sa u përket pretendimeve për Praktikën e Ndaluar, në lidhje me Projektin (duke përfshirë çdo transaksion të financuar ose të propozuar për t'u financuar, tërësisht ose pjesërisht, nga të ardhurat e Huas).”.

H. Me shtimin e një përkufizimi të ri, “Veprim rregullues” në seksionin 1.02 të Marrëveshjes Originale, si më poshtë:

“‘Veprim rregullues’ është një veprim i tillë siç përcaktohet në Praktikën dhe Procedurat Përmbartimore të Bankës.”.

I. Me shtimin e një përkufizimi të ri, “Veprim përmbartues” në seksionin 1.02 të Marrëveshjes Originale, si më poshtë:

“Veprim Përmbarues’ është një veprim i tillë siç përcaktohet në Praktikën dhe Procedurat Përmbarimore të Bankës.”.

J. Me shtimin e një përkufizimi të ri “Praktika dhe procedurat përmbarimore” në seksionin 1.02 të Marrëveshjes Origjinale, si më poshtë:

‘Praktika dhe Procedurat Përmbarimore’ është Praktika dhe Procedurat Përmbarimore të Bankës në fuqi që nga data e specifikuar në Marrëveshjen e Huas, të ndryshuar herë pas here, dhe çdo praktikë ose procedurë e miratuar nga Banka si pasuese ose zëvendësuese e kësaj praktike dhe procedurave.”.

K. Me shtimin e një përkufizimi të ri “IPAM” në seksionin 1.02 të Marrëveshjes Origjinale, si më poshtë:

“IPAM’ është mekanizmi i pavarur i përgjegjshmërisë të Projektit të Bankës, siç përcaktohet në Praktikën e Përgjegjshmërisë së Projektit, i prillit 2019, i ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar herë pas here.”.

L. Përkufizimi i “MTI-së” në seksionin 1.02 të Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“MIE” është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë e Republikës së Shqipërisë.”.

M. Seksioni 2.01 i Marrëveshjes origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“Seksioni 2.01. Shuma dhe valuta

Banka pranon t’i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të specifikuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, shumën prej 77,570,000 euro.”.

N. Seksioni 3.01 (f) i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi.

O. Seksionet 5.01 (e), (f), (g), (h), (i) dhe (j) të Marrëveshjes Origjinale fshihen në tërësi.

P. Seksioni 6.01 i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“Seksioni 6.01. Njoftimet

Adresat e mëposhtme janë të specifikuara për qëllime të seksionit 10.01 të Termave dhe Kushteve Standarde:

Për Huamarrësin:

Ministra e Financave

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 3

Tiranë

SHQIPËRI

Në vëmendje të: Ministrisë së Financave

Email: sekretariamin@financa.gov.al

Për Bankën:

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

5 Bank Street

London E14 4BG

United Kingdom

Në vëmendje të: Departamentit të Shërbimeve Bankare

Email: bankingservices@ebrd.com”

Q. Skeduli 1 (Përshkrimi i Projektit) i Marrëveshjes Origjinale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“SKEDULI 1 – PËRSHKRIMI I PROJEKTT

1. Qëllimi i Projektit është të asistojë Huamarrësin në rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe Durrësit, me gjatësi të përafërt prej 34.17 km dhe ndërtimin e një lidhjeje të re hekurudhore rreth 5 km në gjatësi për t’u lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe zëvendësimin e tij me linjën ekzistuese.

2. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme, sipas ndryshimeve të tilla, për të cilat Banka dhe Huamarrësi mund të bien dakord herë pas here:

Pjesa A. Punimet e ndërtimit që lidhen me: i. rehabilitimin e linjës ekzistuese hekurudhore midis qyteteve të Tiranës dhe të Durrësit, me një gjatësi të përafërt prej 34.17 km; dhe ii. ndërtimin e një linje të re hekurudhore rreth 5 km të gjatë për t’u lidhur me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe zëvendësimin e tij me linjën ekzistuese.

Pjesa B. Shërbimet e konsulencës për mbështetjen e zbatimit të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve për pjesën A.

Pjesa C. i. Ndërtimi i rreth tetë stacioneve hekurudhore dhe ndalesave përgjatë linjës hekurudhore Tiranë–Durrës dhe lidhjes së re hekurudhore me Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës; ii. rritjet e kostos për pjesën A; dhe iii. dhënia e shërbimeve të mbikëqyrjes së punimeve shtesë të kërkuara për stacionet, si dhe për pjesën A.

3. Projekti pritet të përfundojë deri më 31 gusht 2025.”.

R. Shtojca në skedulin 2 (Kategoritë dhe tërheqjet) të Marrëveshjes Originale fshihet në tërësi dhe zëvendësohet me sa vijon:

“BASHKËLIDHJE E SKEDULIT 2

Kategoria	Shuma e Huasë së alokuar në Valutën e Huasë	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen
(1) Punimet e ndërtimit për Pjesën A	65,356,300 EURO	100%, pa përfshirë taksat
(2) Punimet e ndërtimit për Pjesën C	[10,447,500 EURO]	100%, pa përfshirë taksat
(3) Shërbime konsulence për mbështetjen e zbatimit të Projektit dhe mbikëqyrjen e punimeve për Pjesën C	[1,194,000 EURO]	100%, pa përfshirë taksat
(4) Komisioni fillestar për pjesën A	513,700 EURO	100%
(5) Komisioni fillestar për pjesën C	[58,500 EURO]	100%
Totali	77,570,000 EURO	

LLOGARITJET E KOSTOS SË PROJEKTTIT DHE PLANI I FINANCIMIT

Kostot e Projektit & Planit i Financimit (EURO m)	Huaja e BERZHI-t	Granti i BERZH-it	Qeveria e Shqipërisë		
			Granti i BE-së/KIBP-it		
Punime civile (përfshirë kontigjencën)	76.37		32.935		109.305
Dizajni i detajuar & dokumentet e tenderit*		0.075	1.215		1.29
Mbikëqyrja e punimeve	1.2		1.5		2.7
Mbështetja për zbatimin			1		1
Forcimi i kapaciteteve të Institucionit*		0.87			0.87
Marrja e tokës				3.2	3.2
TVSH-ja				23.24	23.24
Totali	77.57	0.945	36.65	26.44	141.605

* Ky komponent i Projektit është përfunduar.*